

Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë që lidhen me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik (adresa postare/elektronike për depozitimin e kërkesave dhe ankesave - afatet dhe mënyrat e kthimit të përgjigjeve).

Çdo person gëzon të drejtën e njohjes së një informacioni publik apo të një ankese drejtuar autoriteteve publike.

Në Institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër për dërgimin e një kërkesë ose ankese duhet të përdoret adresa postare ose adresa elektronike, si më poshtë:

Prefekti i Qarkut Shkodër

Adresa: Rruga “Rruga “28 Nëntori”

E-mail: prefekti.shkoder@mb.gov.al

Afatet dhe mënyrat e kthimit të përgjigjeve kryhet brenda afateve ligjore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i perditesuar, si dhe Ligji nr.44/2015 Kodi i Procedurës Administrative.

Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose email, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit. Në çdo rast, kërkesa për informim regjistrohet dhe për të caktohet një numër rendor i cili së bashku me të dhënat e kontaktit të Koordinatorit për të drejtën e informimit, i jepet kërkuarit. Informacioni jepet pa pagesë, në të njëjtën mënyrë në të cilën është kërkuar. Kërkesa për informim duhet të përmbajë emrin dhe mbiemrin e kërkuarit, adresën postare/elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni, përshkrimin e informacionit, formati në të cilin preferohet si dhe çdo të dhënë tjetër që kërkuari gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.

Ankesa mund të bëhet në formë të shkruar, me postë ose elektronike, të deklarohet verbalisht para institucionit duke u regjistruar nga ky i fundit ose në çdo formë tjetër të përshtatshme. Ankesa gjithashtu duhet të përmbajë identitetin e ankuesit, qëllimin e ankesës, adresën e ankuesit si dhe çdo të dhënë tjetër që ankuesi gjykon se mund të ndihmojë në trajtimin e ankesës.

Trajtimi i kërkesës/ankesës dhe kthimi i përgjigjes bëhet sa më shpejt të jetë e mundur por **jo më vonë se 10 ditë pune** nga data e dorëzimit të saj.